



**VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI  
(Rishqyrtim)**

**Data e miratimit: 15 janar 2013**

**Nr. i lëndës 2011-28**

**Y.**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 15 janar 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është parashtruar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

## **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 12 dhjetor 2011. Ankuesi ka kërkuar që mos të paraqitet emri i tij, pasi frikësohej nga pasojat që ai dhe familja e tij mund të kenë nëse identiteti i tij bëhet publik.
2. Më 5 qershor 2012, Paneli ka vendosur ta njoftoj rreth ankesës shefin e misionit (më pas: ShM-në) të EULEX-it në Kosovë, duke ftuar atë që të paraqes vërejtjet e tij me shkrim lidhur me ankesën. Paneli gjithashtu ka vendosur të shqyrtoj meritat e aplikacionit si dhe në të njëjtën kohë edhe të pranueshmërisë së tij (Rregulla 30 §§ 1 dhe 2 e rregullores së punës së Panelit, më tutje: RrP). Vërejtjet e ShM-së janë marrë më 14 shtator 2012. Më pas, ato i janë komunikuar ankuesit për vërejtje shtesë. Më 4 tetor 2012, ankuesi ka parashtruar vërejtjet e tij shtesë, të cilat i janë përcjellë ShM-së sa për njoftim. Nuk janë kërkuar vërejtje të tjera.
3. Më 15 nëntor 2012, Paneli ka gjetur këtë ankesë të papranueshme.
4. Më 13 janar 2013, ankuesi ka kërkuar rishikimin e pranueshmërisë së ankesës sipas Rregullës 43 të Rregullores së punës së Panelit. Mirëpo, Paneli ka vendosur se rregulla e zbatueshme është Rregulla 42 dhe se do ta shqyrtoj kërkesën e ankuesit në bazë të dispozitës së fundit.

## **IV. LIGJI**

### **Kërkesa për rishikim**

5. Ankuesi ka kërkuar nga Paneli që të rishqyrtoj vendimi e tij të datës 15 nëntor 2012. Ai pohon se Paneli në vendimin e tij nuk kishte marrë parasysh disa dëshmi të dokumentuara, pra certifikatat mjekësore të gruas së tij. Sipas mendimit të ankuesit, dokumentet dëshmojnë se përkeqësimi i shëndetit të gruas së tij ishte pasojë e veprimeve të EULEX-it.
6. Paneli konstaton se dokumentet e përmendura në kërkesën për rishqyrtim, që fillimisht ishin dërguar nga ankuesi përmes postës elektronike me 8 mars 2012 asnjëherë nuk kanë arritur në Sekretariatit e Panelit.
7. Paneli vëren se procedura për rishqyrtim sipas Rregullës 42 nuk është ndonjë mundësi për ankuesin e pasuksesshëm që të rihap lëndën. Nuk ofron as edhe ndonjë mekanizëm për t'i çuar përpara argumentet e reja që nuk kanë qenë të përfshira në ankesën fillestare.
8. Më saktë, procedura për rishqyrtim që ofrohet me Rregullën 42 ka për qëllim që të ofroj një mekanizëm procedural përmes së cilës një

ankues mund të kërkoj rishqyrtimin e një vendimi të papranueshëm, kur një fakt i ri, të cilin ai me arsye nuk ka mundur ta dijë atëherë kur së pari e ka parashtruar ankesën, do të kishte pasur ndikim vendimtar në gjetjet e Panelit.

9. Në këtë lëndë, ankuesi nuk ka arritur të vërtetoj se ai ishte njoftuar rreth ndonjë fakti të ri, që ka mundur të kishte pasur ndikim vendimtar në vendimin e Panelit, pas ankesës fillestare, apo se një fakt i tillë nuk ka mundur që në mënyrë të arsyeshme të dihej nga ai në momentin e parashtrimit të ankesës fillestare. Dëshmia e re që do të ofroj fakte të njëjta ashtu siç ishin paraqitur në vendimin e pranueshmërisë së Panelit, në parim nuk ofron bazë të mjaftueshme për të bërë ndonjë rishqyrtim. Paneli përmbahet nga paraqitja e pikëpamjes së vet sa i përket ndonjë lënde ku dëshmia e re do të tregonte se Paneli ka kryer gabim faktit, i cili ka ndikuar në vendim.
10. Në këtë lëndë, ankuesi nuk ka treguar ndonjë fakt të ri në përputhje me Rregullën 42 dhe nuk ka vërtetuar se sa dokumente të reja, veç e veç apo si tërësi do të kishin ndikim vendimtar në ndonjë prej gjetjeve materiale të bëra nga Paneli në vendimin e tij të papranueshmërisë.
11. Mirëpo, në aplikacionin e tij ankuesi përmend tri dokumente, të cilat ai fillimisht i kishte dërguar Panelit, por për shkaqe teknike, të cilat nuk i ngarkohen atij, nuk kishin arritur deri tek anëtarët e Panelit. Paneli ka vendosur të rishqyrtoj pranueshmërinë e kësaj ankese brenda kuptimit të Rregullës 42 të Rregullores së vet në lidhje me këto dokumente.
12. Në përputhje me këto, Paneli tashmë ka shqyrtuar të gjitha këto tri dokumente dhe ka shqyrtuar nëse këto do të kishin ndikim në ndonjë prej gjetjeve të tij lidhur me faktet.
13. Duke vepruar kështu, Paneli njëzëri ka nxjerrë përfundim se këto dokumente nuk ndikojnë thelbësisht në vendimin për ta shpallur ankesën të papranueshme. Paneli pranon, sidoqoftë, se fjalia e fundit e paragrafit 41 e vendimit të tij të papranueshmërisë bëhet jo e saktë përderisa ankuesi në të vërtetë kishte dërguar informata mjekësore (të cilat nuk kishin arritur deri tek Paneli).
14. Sidoqoftë, sa i përket meritave të ankesës, dokumentacioni mjekësor nuk ofron bazë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të konkluduar se gjendja prej së cilës vuan gruaja e ankuesit është pasojë e ndonjë shkeljeje të të drejtave themelore të ankuesit (po të gruas së tij) që mund t'i ngarkohet EULEX-it.
15. Në atë bazë, Paneli vërteton vendimin e tij për papranueshmëri.

**PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI,**

*Pranon* kërkesën e ankuesit për ta kryer rishqyrtimin.

*Rishqyrton* vendimin e tij për papranueshmëri të datës 15 nëntor 2012.

*Shpall* këtë ankesë të papranueshme.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese